

# **E DREJTA E PROTESTËS NË KOHË PANDEMIE**



## **LETËR E HAPUR**

### **“E DREJTA E PROTESTËS NË KOHË PANDEMIE”**

#### **DREJTUAR:**

**MINISTRISË SE SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**

**KOMITETIT TEKNIK TË EKSPERTËVE TË PANDEMISË**

**KRYEMINISTRIA**

**KOMISIONI PËR PUNËN, ÇËSHTJET SOCIALE DHE SHËNDETËSINË  
MINISTRISË SË BRENDSHME**

**PËR DIJENI: KËSHILLI KOMBËTAR I SHOQËRISË CIVILE**

**KËSHILLI I EUROPËS**

**DELEGACIONI I BASHKIMIT EUROPIAN NË TIRANË**

**AMBASADA AMERIKANE**

Të nderuar Ministre e Shëndetësisë, Ministër i Brendshëm dhe anëtarë të Komitetit Teknik të Ekspertëve në Shqipëri!

Vlerësojmë maksimalisht angazhimin tuaj gjatë kësaj periudhe të veshtirë pandemie për të siguruar shëndetin publik të qytetarëve, përfshirë nevojën për të vendosur masa kufizuese për të minimizuar transmetimin e virusit. Megjithatë kufizimet e marra mund të kenë një qëllim legjitim për të minimizuar shëndetin dhe mirëqënien e komunitetit, disa prej tyre limitojnë të drejtën themelore të njeriut për t'u organizuar në tubime dhe për t'u shprehur lirisht.

Tashmë prej 8 muajsh protestat dhe tubimet në vendin tonë janë të ndaluara me ligj bazuar në Aktin Normativ nr. 3, dt 15/03/2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga covid-19” dhe Urdhrin e Ministres së Shëndetësisë nr.351 dt 20/05/2020. Ne si organizata të shoqërisë civile dhe sindikata të pavarura na është dashur të adresojmë shqetësimet tona jo vetëm në rrugë institucionale, por edhe nëpërmjet protestave paqësore, të cilat na janë

mohuar dhe refuzuar nga policia e shtetit si të paligjshme. Për këtë arsye shume aktivistë dhe qytetarë janë gjobitur dhe proceduar për pjesëmarrje në tubime të paligjshme.

Duam t'ju sjellim në vëmendje se liria e tubimit dhe organizimit paqësor është e garantuar nga neni 47 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 11 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe kufizimet e vendosura ndaj kësaj të drejte duhet të jenë proporcionale me gjendjen që e ka shkaktuar nevojën për vendosjen e tyre dhe kuresesi nuk mund të ketë mohim absolut të kësaj të drejte. Emergjencia publike nuk duhet të jetë justifikim për të mohuar dhe kufizuar hapësirën e shoqërisë civile dhe sindikatave dhe shkelur parimet e demokracisë. Heshtja e kësaj të drejte është heshtje e zërit kundra.

Për më tepër vërejmë që nuk ka një koherencë në vendimet e marra nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ndërkohe që lejohen pishinat, kinematë, konferencat, etj vazhdon të mos lejohet e drejta e tubimit. Të dhenat nga studime të ndryshme në bote tregojnë që protestat nuk jane faktori kryesor në perhapjen e Covid-19 duke qënë se zhvillohen në ambiente të hapura dhe me maska.

Paradoksalisht, ne kemi qënë dëshmitarë dhe kemi ndjekur përmes medias dhe rrjeteve sociale aktivitete, tubime dhe koncerte të organizuara nga partitë politike dhe institucionet publike në vend të cilat nuk janë ndaluar nga Policia e Shtetit, duke dëshmuar një zbatim me dy standarte nga ana e Policisë së Shtetit të akteve ligjore që kanë ndaluar të drejtën e grumbullimit dhe tubimit në Shqipëri. Ky perdorim i standarteve të dyfishta është dhunim dyfish në frymen e të drejtave dhe të lirive të njeriut.

Duke vlerësuar angazhimin tuaj gjatë kësaj periudhe të vështirë për vendin, referuar shembujve ndërkombëtarë dhe të Rajonit, ku e drejta e tubimit nuk është e mohuar në asnjë rast, dhe në funksion të krijimit të mundësive që qytetarët të realizojnë të gjitha të drejtat e tyre kushtetuese

#### **KËRKOJMË QË:**

- Të rishikohen masat dhe udhëzimet në lidhje me të drejtën e tubimit. Masat të jenë proporcionale në mënyrë që të respektojnë të dyja interesat publike, atë të shëndetit publik dhe të drejtën e tubimit. Rekomandimi është të caktohet një protokoll për organizimin e protestave në kohë pandemie ku të parashikohen elemente të veçantë si sipërfaqja, numri i pjesëmarrësve, masat mbrojtëse ndaj përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga Covid 19 dhe parimi i proporcionalitetit.
- Të ketë transparence dhe dialog me shoqëri civile dhe institucionet shtetërore në lidhje me marrjen e masave dhe vendimeve.
- Ndërprerje të menjëhershme të praktikës së deritanishme të strukturave të Policisë së Shtetit për moslejimin e grumbullimeve/tubimeve në ambiente të hapura nga ana e shoqërisë civile.

Këto kërkesa jane edhe rekomandime te institucionit të Avokatit të Popullit, si institucion që nxit standartet më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut, të bëra me shkresë Nr K2/R 5-2 datë 26/10/2020 mbi keto çështje.

Mbetemi në pritje të reagimit tuaj pozitiv për të garantuar të drejtën themelore kushtetuese të qytetarëve shqiptarë për tu organizuar.